

V E N D I M
Nr. 61, datë 22.11.1999

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga :

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““

Me sekretare Drita Filto, më datat 5.10.1999, 11.10.1999 dhe 18.10.1999, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.55 Akti që i përket :

K Ë R K U E S: KRYEMINISTRI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, i përfaqësuar nga zoti Qirjako Qirko, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, i përfaqësuar nga zoti

Viktor Gumi, Këshilltar juridik.

2. SHËRBIMI INFORMATIV KOMBËTAR, i përfaqësuar nga drejtori, zoti Fatos Klosi

O B J E K T I :

Shfuqizimi i ligjit nr.8479, datë 29.4.1999 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8391, datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”. Baza ligjore: Nenet 92/f, 132/1, 131/a dhe 124/1 të Kushtetutës

Kërkuesi ka parashtruar fillimisht se në këtë ligj nuk ka gjetur pasqyrim ndryshimi që i ka bërë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë emërimit të institucionit shtetëror të Shërbimit Informativ Kombëtar.

Në kundërshtim me këtë dhe me projektin e paraqitur nga Qeveria, Kuvendi pa argumenta bindës nuk ka pranuar që këtë institucion qendror ta emërtojë Shërbim Informativ i Shtetit dhe në ligjin e ri e ka lënë të pandryshuar emërtimin e tij të mëparshëm, Shërbim Informativ Kombëtar.

Por, për vetë natyrën sekrete që ka ky organ, i cili është në varësi të Kryeministrit, nuk mund të mbajë më këtë emër, pasi veprimtaria e tij me Kushtetutën e Re ka marrë një kuptim tjetër.

Nga ana tjetër, duke insistuar gjithnjë për shfuqizimin në tërësi të ligjit të sipërpërmendur, përfaqësuesi i palës kërkuese, gjatë seancës gjyqësore pretendoi se në miratimin e këtij ligji është shkelur procedura e parashikuar në nenin 81 shkronja “f” të Kushtetutës, pasi ai është votuar jo nga 3/5 e anëtarëve të Kuvendit.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësuesve të palës kërkuese, të subjekteve të interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkesa e Kryeministrit është pjesërisht e drejtë. Ajo duhet pranuar, duke e shfuqizuar për papajtueshmëri me Kushtetutën jo në tërësi ligji nr.8479, datë 29.4.1999 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8391, datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, por vetëm ato pjesë që kanë të bëjnë me emërtimin e këtij organi.

Për koneksitet, kufijtë e shqyrtimit të kërkesës duhet të shtrihen edhe në ligjin bazë në ato dispozita që nuk i janë nënshtruar këtyre ndryshimeve.

Në nenin 92 shkronja “f” Kushtetuta përdor emërtimin “Shërbimi Informativ i Shtetit” dhe jo “Shërbimi Informativ Kombëtar”. Në këto kushte ligjvënësi duhej t’i përmbahej tekstit të Kushtetutës

dhe të bënte në ligjin e ri zëvendësimin e termit të mëparshëm me termin që përdor ajo. Pra, të vepronte ashtu siç ka vepruar kur ka zëvendësuar emërtimin “Kryetar i Këshillit të Ministrave” me emërtimin “Kryeministër” ose emërtimin “Kryetar” e “Zëvendëskryetar”, me emërtimin “drejtor” e “zëvendësdrejtor”. Mosrespektimi i kësaj kërkesë, përbën shkelje të Kushtetutës. Prandaj Gjykata çmon se termi “Kombëtar” duhet të mënjanohet nëpërmjet shfuqizimit nga të gjitha dispozitat e ligjeve të sipërpërmendura.

I ndryshëm është qëndrimi i Gjykatës përsa i përket pretendimit të palës kërkuese, të ngritur gjatë seancës gjyqësore, sipas të cilit për miratimin e ligjit në fjalë nuk është respektuar procedura e parashikuar në nenin 81 shkronja “a” të Kushtetutës, sepse është votuar jo nga 3/5 e anëtarëve të Kuvendit.

Një pretendim i tillë është i pabazuar. Shërbimi Informativ i Shtetit nuk është organ kushtetues dhe për pasojë nuk përfshihet në kategorinë e atyre institucioneve për të cilat Kushtetuta kërkon që ligjet për organizimin dhe funksionimin e tyre të miratohen me shumicë të cilësuar votash.

Shërbimi Informativ i Shtetit është institucion që Kushtetuta e përmend vetëm përsa i përket emërimit të titullarit të tij në kompetencë të Presidentit të Republikës. Trajtimi që i bën atij Kushtetuta është i ndryshëm nga i institucioneve të tjera që ajo parashikon drejtpërsëdrejti, siç janë Kuvendi, Presidenti, Këshilli i Ministrave, Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë etj., të cilat janë institucione kushtetuese në kuptim të nenit 81 pika 2 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/a e 132/b të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenit 41 të ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Të shpallë të papajtueshëm me Kushtetutën vetëm emërtimin “Kombëtar” në dispozitat e ligjit nr.8479, datë 29.4.1999 “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, si edhe në dispozitat e ligjit të nr.8391, datë 28.10.1998.

2. Rrëzimin e kërkesës për pjesën tjetër që ka të bëjë me shfuqizimin e ligjit nr.8479, datë 29.4.1999.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Kërkesa e Kryeministrit përveç argumentave të përmendura në vendim për procedurën e miratimit të ligjit, duhej të rrëzohej edhe në themel për këto arsye:

1. Objekti i kërkesës është shfuqizimi si antikushtetues i ligjit nr.8479, datë 29.4.1999 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8391, datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, për shkak të emërimit të organit si “Shërbim Informativ Kombëtar” dhe jo si “Shërbim Informativ i Shtetit”, siç e përcakton Kushtetuta. Por, një emërtim i tillë (Shërbim Informativ Kombëtar) është bërë në ligjin bazë nr.8391, datë 28.10.1998 dhe jo në ligjin nr.8479, datë 29.4.1999. Ky i fundit ka bërë disa zëvendësime të fjalëve dhe shprehjeve në ligjin e mëparshëm, por pa përmendur fare emërtimin e organit. Prandaj, kërkesa për shfuqizim të ligjit nr.8479, datë 29.4.1999 përsa i përket emërimit është e pabazuar.

2. Shërbimi Informativ Kombëtar nuk është organ kushtetues, prandaj edhe emërtimi i tij nuk është përcaktuar drejtpërdrejt në Kushtetutë. Emërtimet e ndryshme që mund t’i bëhen këtij organi nuk çenojnë kompetencat dhe veprimtarinë e tij të përcaktuara në ligjin bazë. Ato mbeten siç janë përcaktuar në ligj, pavarësisht nga emërtimi i organit. Për rrjedhim, në aspektin e kontrollit kushtetues, nuk ka rëndësi emërtimi që ligjvënësi i ka bërë këtij organi, përderisa termi në vetevete, në këtë rast,

nuk përbën problem kushtetues.

3. Pretendohet se Kushtetuta ka bërë një emërtim tjetër të këtij organi sepse në nenin 92/f përmendet se Presidenti i Republikës “emëron drejtorin e Shërbimit Informativ të Shtetit”, prandaj emërtimi me ligj i organit si “Shërbim Informativ Kombëtar”, është antikushtetues. Ky pretendim nuk qëndron sepse Kushtetuta, në dispozita të veçanta përdor edhe terma të tjerë siç janë ato të nenit 168/3 (Këshilli i Sigurimit Kombëtar), në nenin 69 (punonjësit e Sigurimit Kombëtar) etj. Ky i fundit ka të bëjë drejtpërsëdrejti me punonjësit e Shërbimit Informativ Kombëtar, por nuk do të thotë se përcakton emërtimin e organit. Shprehja e përdorur në këtë nen ka për qëllim të tregojë se punonjësit e Sigurimit Kombëtar (dhe të tjerë të përmendur shprehimisht), nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë pa hequr dorë nga detyra. Këtë qëllim ka edhe shprehja në nenin 92/f të Kushtetutës, që përcakton një nga kompetencat e Presidentit të Republikës për të emëruar drejtorin e këtij organi. Dy termat e përdorura nga Kushtetuta, si ai në nenin 69 ashtu dhe ai në nenin 92, janë të barazvlefshme, por asnjëri prej tyre nuk ka bërë emërtimin e organit. Prandaj, shprehja e përdorur në nenin 92 nuk mund të shërbejë si argument për pranimin e kërkesës. Me qenë se emërtimi i këtij organi nuk është bërë nga Kushtetuta, i takon ligjvënësit që ta saktësojë atë.

Nga ana tjetër, sipas fjalorit të gjuhës shqipe, fjala “kombëtar”, në një variant të saj njehsohet me fjalën “shtetëror”, pra edhe në këtë aspekt nuk ka ndonjë shmangie në emërtim. Duke iu referuar parashkrimit sa më sipër mendoj se kërkesa e Kryeministrit për papajtueshmëri të ligjit me Kushtetutën për shkak të emërtimit të organit, duhet të ishte rrëzuar si e pabazuar.

A N Ë T A R I

K. Peçi

MENDIMI I PAKICËS

Kërkesa e Kryeministrit nuk është e bazuar dhe duhet rrëzuar jo vetëm përse i përket shfuqizimit në tërësi të ligjit nr.8479, datë 29.4.1999 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8391, datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, por edhe për ndryshimin e emërtimit të këtij organi nga Shërbim Informativ Kombëtar në Shërbim Informativ i Shtetit.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton parimet kryesore të organizimit e të veprimtarisë së disa organeve shtetërore: Kuvendit, Presidentit, Këshillit të Ministrave e Kryeministrit, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë etj. Për shumë organe të tjera ajo nuk bën ndonjë rregullim dhe si rrjedhojë nuk merret as me emërtimin e tyre, gjë që nënkupton që emërtimi do të përcaktohet me ligjet për organizimin e veprimtarinë e këtyre organeve. Në rastin në shqyrtim, emërtimi, Shërbimi Informativ Kombëtar, nuk është përcaktuar në Kushtetutë, por në ligjin nr.8391, datë 28.10.1998.

Fakti që Kushtetuta në nenin 92, kur ka përcaktuar kompetencat e Presidentit të Republikës, e përmend si kompetencë edhe emërtimin e “drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, nuk do të thotë se ka përcaktuar edhe emërtimin e Shërbimit Informativ. Kjo se qëllimi i dispozitës është përcaktimi i kompetencës së Presidentit dhe jo emërtimi i organit.

Vetë Kushtetuta, për emërtimin e këtij organi, nuk është konsekuente sepse ndërsa në nenin 92 e përmend si Shërbim Informativ të Shtetit, në nenin 69/c, kur përcakton personat që nuk mund të kandidojnë si deputetë përmend emërtimin sigurim kombëtar.

Po të bëjmë interpretimin gramatikor të gërmës “f” të nenit 92 të Kushtetutës dhe po ta krahasojmë me emërtimet e organeve në paragrafet e tjerë të këtij neni, shihet se disa organe e institucione emërtohen me gërmë të madhe si në rastin e Kryetarit të Akademisë së Shkencave apo të Kryeministrit etj. Në këtë rast, mund të interpretohet se këto emërtime janë të përcaktuara e nuk mund të ndryshojnë me ligj. Në raste të tjera si për “drejtorin e shërbimit informativ” apo “rektorët e universiteteve”, etj., i paraqet me gërmë të vogël, pra del se emërtimet e tyre mund të përcaktohen e të ndryshojnë me ligj.

Vetë Kuvendi i Republikës, nuk e konsideron të papërshtatshëm termin “sigurim kombëtar”, sepse këtë e përmend edhe në ligjet e tjera të miratuara prej tij. Kështu, psh., në ligjin nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e kualifikuar sekret shtetëror”, qysh në nenin 2 përcakton se “Sigurim Kombëtar do të thotë mbrojtja e pavarësisë, integritetit territorial, rendit kushtetues dhe marrëdhënieve me jashtë të Republikës së Shqipërisë”.

Përse sipër jam për rrëzimin në tërësi të kërkesës.

A N Ë T A R
K. Puto

Tiranë, më 22.11.1999
Nr. 54 i regjistrimit themeltar
Nr. 61 i vendimit